



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:102180

Datë: 11.05.2023

Numri i dokumentit: 04272158

C.nr.2560/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Egzon Mujaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësve Xh.B. (PK...), S.K.(PK...), E.A. (PK...), I.G. (PK...) dhe O.B. (PK...), të cilët sipas autorizimit i përfaqëson B.P, avokat nga V., kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme - Polica e Kosovës, me seli në P., përfaqësuar nga A.Sh., me objekt kontesti, pagesë e shpërblimit për fund vit, shpërblimit jubilar dhe shujtave ditore, me vlerë të kontestit 23,600.68€, jashtë seancës gjyqësore me datë 10.05.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësve Xh.B., S.K., E.A., I.G. dhe O.B., ashtu që DETYROHET e paditura Ministria e Punëve të Brendshme - Polica e Kosovës, me seli në P., që paditësve t'iu paguaj shumat si më poshtë:

- Paditësit Xh.B., në emër të shpërblimit për fund vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, në vlerë të një page të rregullt mujore për secilin fund vit t'ia paguaj shumën nga 622.06€, e në total për katër vite shumën prej 2,488.24€, ndërsa në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite të përvojës në pune, në vlerë prej 25% të një page mesatare të vitit 2021, shumën prej 142€, apo shumën e përgjithshme prej 2,630.24€.

- Paditësit S.K., në emër të shpërblimit për fund vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, në vlerë të një page të rregullt mujore për secilin fund vit t'ia paguaj shumën nga 569.13€, e në total për katër vite shumën prej 2,276.52€, ndërsa në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite të përvojës në pune, në vlerë prej 25% të një page mesatare të vitit 2021, shumën prej 142€, apo shumën e përgjithshme prej 2,418.52€.

- Paditësit E.A., në emër të shpërblimit për fund vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, në vlerë të një page të rregullt mujore për secilin fund vit t'ia paguaj shumën nga 569.13€, e në total për

katër vite shumën prej 2,276.52€, ndërsa në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite të përvojës në pune, në vlerë prej 25% të një page mesatare të vitit 2020, shumën prej 142€, apo shumën e përgjithshme prej 2,418.52€.

- Padiësit I.G., në emër të shpërblimit për fund vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, në vlerë të një page të rregullt mujore për secilin fund vit t'ia paguaj shumën nga 596.66€, e në total për katër vite shumën prej 2,386.64€, ndërsa në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite të përvojës në pune, në vlerë prej 25% të një page mesatare të vitit 2020, shumën prej 142€, apo shumën e përgjithshme prej 2,528.64€.

- Padiësit O.B., në emër të shpërblimit për fund vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, në vlerë të një page të rregullt mujore për secilin fund vit t'ia paguaj shumën nga 590.69€, e në total për katër vite shumën prej 2,362.76€, ndërsa në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite të përvojës në pune, në vlerë prej 25% të një page mesatare të vitit 2020, shumën prej 142€, apo shumën e përgjithshme prej 2,504.76€.

II. DETYROHET e paditura që padiësve shumat e gjykuara si në pikën -I- të këtij dispozitivi, t'ua paguaj me kamatë ligjore në lartësi prej 8 % në vit, nga data e parashtrimit të padisë 26.05.2021, e gjerë në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës, në lartësi prej 644 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me detyrim.

III. REFUZOHET në tërësi kërkesëpadia e padiësve për pagesë të shujtave ditore për periudhën kohore nga data 14.11.2018 deri më 23.02.2022, për 740 ditë pune, në shumë prej nga 2,220€, për secilin padiës, si dhe në emër të shpenzimeve të procedurës shuma në lartësi prej 1,953€, SI E PA BAZUAR.

A r s y e t i m

Padiësit Xh.B., S.K., E.A., I.G. dhe O.B., përmes përfaqësuesit të tyre të autorizuar, me datë 26.05.2021, në këtë gjykatë, kanë parashtruar padi, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme - Polica e Kosovës, me seli në P., për pagesën e shpërblimit për fund vit, shpërblimit jubilar dhe shujtave ditore.

Përfaqësuesi i padiësve, në padi ka theksuar se padiësit janë të punësuar tek e paditura dhe se të njëjtëve, në bazë të Udhëzimit Administrativ 02/2018, të datës 14.11.2018, iu takon e drejta e pagesës së fund vitit, shpërblimit jubilar dhe shujtave ditore. Me parashtrësën e datës 04.04.2022, ka kërkuar që të detyrohet e paditura që padiësit Xh.B., në emër të shpërblimit të një page mujore

për fund vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, në vlerë të një page ekuivalente të fund vitit përkatës, t'ia paguaj shumën e përgjithshme 2,488.24€, në emër të kompensimit të pagës jubilarë për përvojë të punës 16 vjeçare, të paguaj 25% të një page bazë apo shumën prej 142€ dhe në emër të ushqimit – shujtave ditore ka kërkuar kompensim për periudhën e kohore 14.11.2018 – 23.02.2022, apo për 740 ditë të prezencës në punë, shumën prej 2,220€, paditësit S.K., në emër të shpërblimit të një page mujore për fund vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, në vlerë të një page ekuivalente të fund vitit përkatës, t'ia paguaj shumën e përgjithshme 2,276.52€, në emër të pagës jubilarë për 16 vite përvojë pune, në vlerë prej 25% të një page bazë, shumën prej 142€, si dhe në emër të shujtave ditore për periudhën kohore nga data 14.11.2018 deri më 23.02.2022, për 740 ditë pune, në shumë prej 2,220€, paditësit E.A., në emër të shpërblimit të një page mujore për fund vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, në vlerë të një page ekuivalente të fund vitit përkatës, t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 2,276.52€, në emër të pagës jubilarë për 16 vite përvojë pune, në vlerë prej 25% të një page bazë, shumën prej 142€, si dhe në emër të shujtave ditore për periudhën kohore nga data 14.11.2018 deri më 23.02.2022, për 740 ditë pune në shumë prej 2,220€, paditësit I.G., në emër të shpërblimit të një page mujore për fund vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, në vlerë të një page ekuivalente të fund vitit përkatës, t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 2,386.64€, në emër të pagës jubilarë për 16 vite përvojë pune, në vlerë prej 25% të një page bazë, shumën prej 142€, si dhe në emër të shujtave ditore për periudhën kohore nga data 14.11.2018 deri më 23.02.2022, për 740 ditë pune, në shumë prej 2,220€ dhe paditësit O.B., në emër të shpërblimit të një page mujore për fund vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, në vlerë të një page ekuivalente të fund vitit përkatës, t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 2,362.76€, në emër të pagës jubilarë për 16 vite përvojë pune, në vlerë prej 25% të një page bazë, shumën prej 142€, si dhe në emër të shujtave ditore për periudhën kohore nga data 14.11.2018 deri më 23.02.2022, për 740 ditë pune, në shumë prej 2,220€. Të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% në vit, nga dita parashtrimit të padisë, e deri në pagesën definitive.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë: 624 € për përpilimin e kërkesës pranë të paditurës, 101€ për taksë gjyqësore për padi, 624€ për përpilimin e padisë, 624€ për precizimin e kërkesëpadisë dhe 624€ për zgjerimin e padisë në kuptimin objektiv.

E paditura me përgjigje në padi ka theksuar se e kundërshton në tërësi kërkesëpadinë e paditësve, për faktin se Ministria e Financave nuk e ka aprovuar kërkesën e të paditurës për ndarje të mjeteve buxhetore financiare, dhe si rrjedhojë e kësaj çdo veprim apo nismë, duke përfshirë edhe nenin 29, paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ 02/2018, për Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, i cili prodhon obligime financiare për të paditurën, nuk është i obligueshëm për faktin se të paditurës nuk i janë ndarë mjete buxhetore financiare për pagesë të pagës së fund vitit (pagës

së trembëdhjetë). Lidhur me kërkesën për shujta, ka shtuar se me asnjë dispozite ligjore kjo kërkesë nuk është detyrim për të paditurën. Me propozim për gjykatën që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj në tërësi si të pathemeltë.

Gjykata të paditurës i ka dorëzuar parashtresën e datës 04.04.2022, me të cilën përfaqësuesi i autorizuar i paditësve ka bërë ndryshimin e padisë në kuptimin objektiv, të cilën pala e paditur e ka pranuar me datë 30.12.2022, por nuk është deklaruar lidhur me këtë parashtresë.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe 399 të Ligjit Nr.03/L-006, për procedurën kontestimore, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-118 (LPK), gjeti se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e bazuar, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Duke u nisur nga pohimet e palës paditëse të cekura në padi, theksimet e palës së paditur të dhëna në përgjigje në padi, gjykatës i rezultojë se mes palëve ndërgjyqëse nuk është kontestues fakti se paditësit janë të punësuar tek e paditura, nuk është kontestues përvoja e punës së paditësve tek e paditura, lartësia e pagës së paditësve, si dhe prezenca e tyre në punë.

Si çështje kontestuese për të paditurën, dhënë si në përgjigje në padi, ishte baza e kërkesëpadisë për faktin se sipas të paditurës Ministria e Financave nuk i ka aprovuar kërkesën për ndarjet buxhetore lidhur me kërkesat e pretenduar të paditësve dhe si rrjedhojë e këtij akti të brendshëm i të paditurës, dhe atë Udhëzimi Administrativ 02/2018 nuk prodhon obligime financiare dhe nuk është i obligueshëm për të paditurën.

Nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, dhe atë nga formulari i vlerësimit të performancës vërtetohet fakti se paditësi Xh.B., nga data 08.01.2001, është në marrëdhënie pune tek e paditura ka pasur vlerësim të kënaqshëm të performancës, ndërsa nga vendimi me numër të referencës ..., i datës ..., gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi nga marrëdhënia e punës tek e paditura realizon pagë mujore në lartësi prej 622.06€, paditësi S.K., nga data 08.01.2001, është në marrëdhënie pune tek e paditura ka pasur vlerësim të kënaqshëm të performancës, ndërsa nga vendimi me numër të referencës ..., i datës ..., gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi nga marrëdhënia e punës tek e paditura realizon pagë mujore në lartësi prej 569.13€, paditësi E.A., nga data 20.11.2000, është në marrëdhënie pune tek e paditura ka pasur vlerësim të kënaqshëm të performancës, ndërsa nga vendimi me numër të referencës ..., i datës ..., gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi nga marrëdhënia e punës tek e paditura realizon pagë mujore në lartësi prej 569.13€, paditësi I.G., nga data 20.11.2000, është në marrëdhënie pune tek e paditura ka pasur vlerësim të

kënaqshëm të përformancës, ndërsa nga vendimi me numër të referencës ..., i datës ..., gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi nga marrëdhënia e punës tek e paditura realizon pagë mujore në lartësi prej 596.66€ dhe paditësi O.B., nga data 21.08.2000, është në marrëdhënie pune tek e paditura ka pasur vlerësim të kënaqshëm të përformancës, ndërsa nga vendimi me numër të referencës ..., i datës ..., gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi nga marrëdhënia e punës tek e paditura realizon pagë mujore në lartësi prej 590.69€. Ashtu që katër paga për fund vit për secilin paditës arrin shumën si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata, provave të lartcekura, me të cilat vërtetohen faktet lidhur me marrëdhënien e punës të paditësve tek e paditura, vlerësimet e përformancës së punës dhe lartësinë e pagave të paditësve, ua fali besimin e plotë dhe të njëjtat i pranoi si prova materiale, në kuptim të nenit 329, paragrafi 1, të Ligjit Nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-118, ngase të njëjtat janë dokumente të lëshuar nga vet e paditura.

Bazuar në nenin 2, paragrafi 2, të LPK-së, ku është përcaktuar se “Gjykata i zbaton rregullat e të drejtës materiale sipas vlerësimit të saj dhe nuk është e lidhur me thëniet e palëve që kanë të bëjnë me të drejtën materiale”, gjykata gjen se në këtë çështje juridike kontestimore zbatohen dispozitat e Ligjit Nr.04/L-076, për Policinë, Udhëzimit Administrativ nr.02/2018 dhe Udhëzimit Administrativ nr.01/2021, mbi marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës, të nxjerra nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës.

Me neni 44, paragrafi 2, të Ligjit Nr.04/L-076 për Policinë, është përcaktuar se “marrëdhënia e punës për personelin policor rregullohet me akt nënligjor”.

Me Udhëzimin Administrativ nr.02/2018, në nenin 29, paragrafi 1, 2 dhe 5, si dhe me Udhëzimin Administrativ nr.01/2021, në nenin 30, paragrafi 1, 2 dhe 5, është përcaktuar se “Paga bazë, shtesat për rrezikshmërinë në punë, puna jashtë orarit, gjatë festave, shujtë ditore, veshmbathje (për zyrtarët policorë) dhe sigurim shëndetësor për personelin e Policisë duhet të jetë në përputhje me vendin e punës, gradën, kualifikimin dhe përvojën e punës, duke u mbështetur në Ligjin për Policinë, sistemin e pagave dhe shtesave në Polici. Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit. Personeli policor që është në marrëdhënie të vazhdueshme pune në Policinë e Kosovës iu takon shpërblimi në vlerë prej 25% të pagës mesatare në Policinë e Kosovës pas çdo dhjetë (10) vite pune (paga jubilarë)”.

Gjykata, bazuar në dispozitat sipër cekura dhe gjendjes faktike të provuara si më lartë, aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve, duke e detyruar të paditurën që paditësve në emër të shpërblimit të fund vitit – pagës së 13-të, për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021 t’ua paguaj shumat si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Kjo sepse nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, gjykata ka provuar faktin se paditësit, kanë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet e përcaktuara me nenin 29, paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ 02/2018 dhe nenit 30, paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ 01/2021, për pagesën e shpërblimit të fund vitit – pagës së 13, nga se të njëjtit kanë pasur rezultatet në punë të vlerësuara në nivelin e përcaktuar me dispozitën në fjalë dhe ndaj tyre, për periudhën kohore në fjalë, nuk është shqiptuar asnjë masë disiplinore. Për më tepër e paditura, me anë të përgjigjes në padi, nuk ka parashtruar ndonjë vërejtje lidhur me performancën dhe çështjet eventuale disiplinore ndaj ndonjërit paditës.

Gjykata ka aprovuar kërkesën e paditësve për pagesë të shpërblimit jubilar, në shumën si në pikën -I- të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në nenin 29, respektivisht 30, të udhëzimeve administrative numër 02/2018 dhe 01/2021, pasi që nga vlerësimet e performancës është vërtetuar fakti se paditësit Xh.B. dhe S.K., janë në marrëdhënie pune tek e paditura dhe 10 vite të përvojës së punës (jubileun) i kanë arritur në vitin 2021, ndërsa paditësit E.A., I.G. dhe O.B. janë në marrëdhënie pune tek e paditura dhe 10 vite të përvojës së punës (jubileun) i kanë arritur në vitin 2020.

Lartësia e shpërblimit jubilar e aprovuar i referohet të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, të datës 15.06.2022, nga e cila rezulton se paga mesatare në Policinë e Kosovës, për vitin për vitin 2020 ka qenë 696.30€ dhe për vitin 2021 ka qenë 642.5€ €. Ashtu që shumat e aprovuara paraqesin vlerën prej 25% të pagës mesatare në Policinë e Kosovës, të vitit përkatës në të cilin është arritur viti jubilar nga paditësit pa tejkuluar kërkesëpadinë e paditësve.

Gjykata vendosi si në pikën –III- të dispozitivit të këtij aktgjykimi, lidhur me kërkesën për kompensimin e ushqimit (shujtave ditore), pasi që në vlerësimin e gjykatës paragrafi 1 i nenit 29 të Udhëzimit Administrativ 02/2018 dhe paragrafi 1 i nenit 30 të Udhëzimit Administrativ 01/2021, nuk kanë karakter detyrues dhe si të tilla nuk e obligojnë të paditurën për pagesë të shujtave ditore të pretenduara nga paditësit si në padi.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritot, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”, andaj gjykata vendosi si në pikën

I, dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore, pasi që vlerësoi se në rastin konkret, kërkesëpadia e paditësve bazohet në udhëzimet administrative me numra 02/2018 dhe 01/2021 të Policisë së Kosovës.

Ndërsa gjykata bazuar në nenin 399 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do te jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”, andaj gjykata vendosi si në pikën III, të dispozitiv të këtij aktgjykimi, pa caktuar seancë gjyqësore, për pjesën e refuzuar.

Gjykata i shqyrtoi dhe i vlerësoi pretendimet e të paditurës të dhëna me përgjigje në padi, dhe vlerësoj se të njëjtat janë të pa argumentuara dhe të bazuara, për faktin se e njëjta gjykatës nuk i ka ofruar kurrfarë prove për t’i argumentuar pretendimit si në përgjigje në padi, andaj gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke u bazuar në nenin 7, paragrafi 1, të LPK-së, u është përcaktuar e “palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet, në të cilat i mbështesin kërkesat e tyre dhe të propozojnë prova, me të cilat vërtetohen ato fakte” dhe nenin 319, paragrafi 1, të njëjtit Ligj, ku thuhet se “palët ndërgjyqëse kanë për detyrë të provojnë faktet mbi të cilat i bazojnë kërkesat dhe pretendimet e tyre”.

Për kamatën gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispozitën e nenit 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, ku është paraparë se debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor edhe kamatën, lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit. Ndërsa si datë nga e cila rrjedh detyrimi i të paditurës për pagesën e kamatës, gjykata ka caktuar datën e parashtrimit të padisë në gjykatë, datë 26.05.2021.

Vendimin që pala e paditur t’i bartë shpenzimet e procedurës Gjykata e ka mbështetur në dispozitën nga neni 449 dhe 452, e lidhur me nenin 463 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Lartësia e shpenzimeve të procedurës të aprovuara i referohen shpenzimeve të përfaqësuesit të autorizuar të paditësve dhe atë 624€, për përpilimin e padisë dhe 20€, për taksë gjyqësore për padi (sipas numrit tarifor 6 dhe 7 të tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës, për pesë paditës). Gjykata me rastin e vendosjes lidhur me shpenzimet e procedurës, i mori parasysh vetëm ato shpenzime që kanë qenë të nevojshme dhe që janë krijuar për këtë procedurë.

Andaj duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.2560/2021, datë 10.05.2023

Gjyqtari
Egzon Mujaj

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimet të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.